

Colours of Albania 2019

**Çfarë është
#ColoursOfAlbania2019?**

Fushatë mbarëkombëtare dhe konkurs fotografik në rrjetet sociale (Instagram, Facebook, Twitter) për promovimin e Shqipërisë.

Cila është tema e edicionit të pestë të CoA 2019?

Fushata promovuese e edicionit të pestë të Colours of Albania 2019 është “Zhvillimi urban dhe stili i jetës në Shqipëri”/“Lifestyle and urban development in Albania”. Nëpërmjet imazheve të perceptuara nga ju, kjo temë synon të transmetojë vlera dhe kultura lokale, qytetet shqiptare të riformuara, si dhe mënyrën sesi njerëzit jetojnë.

Si mund të bëheni pjesë e #ColoursOfAlbania2019?

1- Shkrepni foto në Shqipëri në kuadër të temës: “Zhvillimi urban dhe Stili i Jetesës në Shqipëri”.

2- Publikoni foton në profilin tuaj në Instagram, nën hashtag-un #ColoursOfAlbania2019.

3- Mund të dërgoni fotografitë që keni publikuar edhe muaj më parë, mjafton të vendosni hashtag-un #ColoursOfAlbania2019 dhe ju do të bëheni automatikisht pjesë e konkursit.

Kohëzgjatja dhe pjesëmarrësit:

#ColoursOfAlbania2019 do të jetë i hapur deri më 30 Tetor 2019, për të gjithë qytetarët shqiptar dhe të huaj që vizitojnë Shqipërinë, të apasionuarit pas fotografisë, artit, arkitekturës, udhëtimeve, kulturës etj.



Colours of Albania



coloursofalbania



coloursALB